



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.25, datë 20/09/2023

PËR

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES  
NR.SERIE 0017, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.16, DATË  
12.07.2018 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR,  
SUBJEKTIT “PORSCHE ALBANIA” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 0017, miratuar me Vendimin Nr.16, datë 12.07.2018 të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit me koordinata do të saktësohen:

Nga: X=4396300; Y=4580230; Z=65.2m (ALBANIAN 1986/GK4)

Në: X=4396149; Y=4580349; Z=65.2m (ALBANIAN 1986/GK4)

Në : X=479707; Y=4579501; Z= 65.2m (KRGJSH)

- Sasia e ujit që jepet në përdorim:  $Q=1$  l/s
  - Prurja mesatare :  $Q_{mes}= 3$  l/s
  - Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Gropë septike
2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 0017, miratuar me Vendimin Nr.16, datë 12.07.2018 të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm Erzen, “leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime sanitare (shitje dhe riparim automjetesh)”, sipas koordinatave të mësipërme të saktësuara me vendodhje, Autostrada Tiranë-Durrës km.3, Kashar, Bashkia Tiranë.
  3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

